Thirrje Për Shprehje e Interesit

Autoriteti kontraktues **Komuna e** Deçanit, përmes Drejtorisë Për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike, bën ftesë për Shprehje Interesi " **Marrja në Menaxhim dhe Modernizimi i Pritoreve të Autobusëve në** Deçan"

Qëllimi i kësaj thirrjeje është identifikimi i operatorëve ekonomikë të interesuar për partneritet në:

- Vendosja e pritoreve te reja
- modernizimin e pritoreve të autobusëve
- mirëmbajtjen e tyre
- zhvillimin e hapësirave reklamuese digjitale dhe statike.

Ky projekt synon:

- përmirësimin e infrastrukturës urbane të qytetit;
- rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe udhëtarët;
- instalimin e teknologjive moderne për informimin e qytetarëve;
- zhvillimin e hapësirave reklamuese urbane.

Operatori i përzgjedhur do të ketë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave reklamuese në pritore për një periudhë prej **10 (dhjetë) vitesh**.

Në këmbim, operatori obligohet të realizojë:

- modernizimin e pritoreve ekzistuese
- instalimin e monitorëve digjitalë
- mirëmbajtjen e infrastrukturës.
- Ne data te shënuara dhe festa hapësirat reklamuese te jene te rezervuara për komunën e Deçanit

Kjo procedurë zhvillohet në përputhje me:

- Ligjin Nr. **08/L-275 për Rrugët**
- Planin e Mobilitetit të Komunës së Deçanit

- Rregulloren Komunale Nr. **03/2012 për Shërbime Komunale dhe Rend Komunal**

Projekti përfshin:

- kompletimin dhe modernizimin e pritoreve të autobusëve;
- instalimin e **monitorëve digjitalë për reklama**;
- instalimin e **monitorëve për oraret e autobusëve**;
- zhvillimin dhe operimin e platformave digjitale për menaxhimin e reklamave dhe informimit të udhëtarëve;
- mirëmbajtjen teknike të pritoreve dhe pajisjeve për 10 vite

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- pasqyra financiare të audituara për vitet:
  - 2023
  - 2024
  - 2025
- qarkullim minimal total prej **3,000,000 EUR** gjatë kësaj periudhe.

Kërkohet:

- listë e projekteve të realizuara në 3 vitet e fundit;
- vlera totale e projekteve të jetë **minimum 1,000,000 EUR**;
- referencat të mbështeten me dëshmi të transaksioneve bankare.

Operatori duhet të posedojë një **platformë funksionale për menaxhimin e reklamave digjitale**.

Platforma duhet të përfshijë Modulet për:

- menaxhimin e reklamave digjitale
- rezervimin e hapësirave reklamuese
- planifikimin e fushatave reklamuese.

Kërkohet:

- deklaratë e noterizuar për pronësinë e kodit burimor dhe të drejtat e pronësisë intelektuale;
- pamjen skenike (screenshots) që demonstrojnë funksionalitetin e menaxhimit të reklamave.

Operatori duhet të posedojë një aplikacion mobil për informimin e udhëtarëve.

Aplikacioni duhet të përfshijë:

- shfaqjen e orareve të autobusëve në kohë reale

- integrim me GPS
- shfaqjen e pozicionit të autobusëve.

Dokumentacioni i kërkuar:

- dëshmi e publikimit në **Apple App Store** dhe **Google Play Store**
- deklaratë e noterizuar për kodin burimor
- screenshots të aplikacionit.

Operatori duhet të sigurojë:

- lidhje interneti me shpejtësi minimale **50 Mbps**
- monitorë reklamues të përshtatshëm për përdorim në ambient të jashtëm.

Dokumentacioni:

- katalog teknik i pajisjeve
- specifikimet teknike
- autorizim nga prodhuesi për pajisjet.

Kriteri	Pesha
Teknoligjia e aplikacioneve	25%
Cilësia e monitorëve	25%
Kapaciteti financiar	25%
Eksperienca profesionale	25%

Operatori i përzgjedhur obligohet të realizojë investimet për:

- vendosjen e pritoreve të reja
- modernizimin e pritoreve
- instalimin e monitorëve
- zhvillimin e platformave teknologjike.

Detajet e investimit do të përcaktohen në marrëveshjen përfundimtare.

Të gjitha investimet fizike të realizuara në pritore do të mbeten pronë e **Komunës së** Deçanit pas përfundimit të periudhës së kontratës.

Operatorët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikacionin dhe dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komuna do të organizojë **takime prezantuese me operatorët e përzgjedhur**.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

27.10.2026 – 26.11.2026

Aplikimet dorëzohen në mënyrë elektronike në:

Email:
Shaban.Haxhaj@rks-gov.net

Dhe Kopje fizike

Rr Jashar Salihu Nr.03,
Ndërtesa e Komunës e Deçanit
Drejtoria për mbrojtje shpëtim dhe Shërbimeve Publike

Izet Zenuni
Drejtor për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike

DRJ. MB. Sh. Publike 23111
09 27.10.26